



E premte, 14 tetor 2016

NJOFTIM

Mbledhja e IX-t e Bordit të ZRRE

Aprovimi i Tarifave të NQ Termokos dhe NQ Gjakova për sezonën e ngrohjes 2016/17 dhe miratimi i rregullave që qojnë në hapjen e tregut të lirë të energjisë elektrike

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), në mbledhjen e tij të IX, të mbajtur sot me 14 tetor 2016, ka aprovuar tarifat e energjisë termike për Ngrohtoren e Qytetit Termokos sh.a për sezon e ngrohjes 2016/17. Tarifat e reja për konsumatorët e amvisërisë do të jenë për 7% më të ulëta se ato të sezonës së kaluar. Ndërsa tarifat për konsumatorët komercial do të jenë mesatarisht 5% më të ulëta.

Gjithashtu Bordi i ZRRE me kërkesë të ngrohtores së qytetit të Gjakovës, NQ Gjakova, ka vendosur që tarifat e kësaj ndërmarrje të mbesin të njëjta me ato të vitit të kaluar.

Tarifat e reja të energjisë termike (Ngrohjes), si dhe të gjitha dokumentet përkatëse do të publikohen në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së www.ero-ks.org.

Në Mbledhjen e sotme, Bordi ka aprovuar edhe Rregullën për ndërrimin e furnizuesit. Aprovimi i kësaj rregulle është konsideruar një hap shumë i rëndësishme për hapjen e tregut të energjisë elektrike në vend.

Në vijim të angazhimeve për hapjen e tregut të energjisë elektrike, Bordi i ZRRE ka shqyrtuar dhe ka aprovuar po ashtu kërkesën e ndërmarrjes "HEP – KS" SH.P.K për Licencim të aktiviteteve të furnizimit me energji elektrike.

Në këtë mbledhje gjithashtu është licencuar ndërmarrja "ENERGY FINANCING GROUP AD" me degë në Kosovë, për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së edhe më tutje mbetet i përkushtuar në arritjen e synimeve të tij për krijimin e një tregu funksional të energjisë elektrike, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të mira dhe konkurruese për të gjithë konsumatorët e energjisë në vend.